



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo - Territoriale

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2025, ora 12:00

Drejtojnë mbledhjen:

Arbjan Mazniku – bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Konstituimi i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale.

Marrin pjesë:

Arbjan Mazniku, Blendi Klosi, Damian Gjijnuri, Romina Kuko, Ermal Pacaj, Marjana Koçeku, Ermal Elezi, Klevis Jahaj, Edmond Haxhinasto, Vasil Llajo dhe Vangjel Dule.

Mungojnë:

Luçiano Boçi, Jorida Tabaku, Bledjon Nallbati, Xhelal Mziu, Ramadan Likaj dhe Enno Bozdo.

HAPET MBLEDHJA

Arbjan Mazniku – Përshëndetje!

Bazuar në vendimin nr. 75 dhe më pas edhe në vendimin nr. 85 të Kuvendit, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”, sot do të zhvillojmë mbledhjen e parë, konstituive, të Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale.

Sipas vendimit, komisioni ka një numër prej 16 anëtarësh, me bashkëkryesi. Po lexoj fillimisht emrat e anëtarëve, për të pasur mundësi që të kalojmë në fazën tjetër: zoti Klosi, zoti Gjikhuri, zonja Kuko, zoti Pacaj, zonja Koçeku, zoti Elezi dhe zoti Jahaj.

Gjithashtu, kemi prezentë edhe disa nga anëtarët zëvendësues, të cilët do të jenë gjithmonë të mirëpritur në komision. Kemi prezent nga grupi i anëtarëve zëvendësues zotin Llajo. Të gjithë anëtarëve zëvendësues ne do t’u kërkojmë në vijimësi të mbajnë një rol aktiv jo thjesht si zëvendësues, por që të jenë aktivë edhe në procesin e konsultimit, duke qenë se do të zhvillohet një proces i gjatë konsultimi publik në të gjithë territorin.

Nga ana e opozitës kemi zotin Boçi (bashkëkryetar), zonjën Tabaku, zotin Nallbati, zotin Mziu, zotin Likaj, zotin Bozdo, të cilët nuk janë prezentë, si dhe zotin Haxhinasto dhe zotin Dule, të cilët janë prezentë.

Duke qenë se e kemi kuorumin për të vazhduar mbledhjen, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, konstituimin e komisionit të posaçëm parlamentar.

Sot synimi ishte vetëm të kishim një konstituim të këtij komisioni, në mënyrë që të kemi mundësi të fillojmë planin e punës.

Fillimisht dua të them 2-3 fjalë për frymën në të cilën synojmë të organizojmë punën.

Hapim sot një kapitull shumë të rëndësishëm të reformës administrativo-territoriale, i cili është një ndër sfidat më të mëdha që ka vendi në shumë aspekte, jo vetëm në aspektin se si mund të përmirësojmë në mënyrë të qenësishme shërbimet që marrin qytetarët në të gjithë territorin, por në një kënd edhe më të rëndësishëm, që ka të bëjë me integrimin europian.

Ne jemi në derën e Bashkimit Europian. Siç është bërë tashmë e qartë, synohet që deri në fund të vitit 2027 të mbyllet procesi teknik i negociatave, një proces 2-vjeçar, dhe më pas në të bëhet edhe procesi i ratifikimit të marrëveshjes me të gjitha parlamentet e vendeve europiane, që Shqipëria të jetë një vend anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Europian.

Nga ai moment mënyra e organizimit tonë territorial nuk është më një çështje thjesht e lidhur me Shqipërinë, por është një çështje e lidhur ngushtë me programin e kohezionit social të Bashkimit Europian, është e lidhur ngushtë me një sërë programesh të Bashkimit Europian

që mbështetin fondet strukturore, është një element që do të impaktojë në mënyrë të qenësishme mënyrën se si do të zhvillohet vendi në 20-30 vitet e ardhshme.

Pasja e institucioneve vendore të afta për të funksionuar në këtë kuadër kthehet në këtë mënyrë në një sfidë tej mase të rëndësishme, pasi do të impaktojë jo thjesht mënyrën se si këto institucione ofrojnë shërbime, jo si këto institucione ndërveprojnë me pushtetin qendror, por se si këto institucione ndërveprojnë në thelb edhe me bashkësinë e madhe, ku Shqipëria do të jetë anëtare e Bashkimit European.

Pikërisht për këtë arsye është tej mase e nevojshme që ne ta fillojmë këtë proces ekzaktësisht tani, t'i dalim përpara në kohë dhe të sigurohemi që institucionet tona të jenë të gatshme në momentin që Shqipëria do të jetë pjesë e Bashkimit European.

Duhet të themi që ky proces do të kërkojë të gjithë konsensusin e mundshëm dhe ne jemi shumë të gatshëm që të bëjmë një punë sa më të hapur, sa më transparente, sa më bashkëpunuese, së pari me të gjitha forcat politike që janë në Parlament, por më pas edhe me të gjithë aktorët lokalë: bashkitë, qarqet, të zgjedhurit në këshillat bashkiakë të të gjithë vendit, bizneset, pasi është shumë e rëndësishme që ne të flasim me komunitetet e bizneseve, me akademinë, do të punojmë ngushtë me universitetet shqiptare për të kuptuar zgjidhjen më të mirë të problematikave dhe për të ndërvepruar me ta në mënyrë sistematike).

Sigurisht, ne kemi treguar tashmë edhe në diskutimet paraprake të gjithë gatishmërinë për të ndërvepruar me institucionet ndërkombëtare, me Kongresin e Autoriteteve Vendore, me Bashkimin European drejtpërdrejt, me disa programe të rëndësishme, me disa nga partnerët, të cilët kanë punuar në mënyrë të qenësishme gjatë kësaj kohe në pushtetin vendor, ku dy më kryesorët janë qeveria zvicerane dhe ajo suedeze me dy programe të rëndësishme që kanë pasur në mbështetje. Dhe sigurisht, në mënyrë më normale, në mënyrë horizontale, do të ndërveprojmë me të gjitha institucionet e vendit, për t'u siguruar që të ndërlihim mënyrën më të mirë të mundshme kompetencat që bashkitë kanë, territorin dhe mundësitë administrative që ato kanë.

Objektivi final është që të krijojmë një reformë, ku të sigurohemi që të kemi institucione të afta, eficiente dhe demokratike; të sigurohemi që të kemi struktura që të jenë pranë njerëzve, t'i dëgjojnë problemet e njerëzve, të përfaqësojnë shqetësimet e tyre, por të jenë edhe të afta në të njëjtën kohë për t'ua zgjidhur në mënyrë eficiente problemet.

Besoj se është e rëndësishme të themi 2-3 gjëra edhe për faktin si kemi ardhur këtu. Duhet të kemi parasysh që fiks para 10 vjetësh është bërë një reformë tjetër shumë e rëndësishme. Disa nga anëtarët e komisionit kanë qenë pjesëtarë edhe të reformës së vitit 2014, një reformë që unë besoj se ishte jashtëzakonisht e rëndësishme, e cila e çoi strukturën nga 373

njësi të vogla në 61 bashki. Ajo reformë ka pasur një sërë efektesh shumë të mira për vendin tonë. Mjafton të jap disa numra, të cilët besoj se janë të rëndësishëm për të krijuar një kontekst të mënyrës si kemi ardhur nga viti 2014 deri këtu, të cilët mund të jenë një indicie e mirë për rrugën si mund të ecim përpara.

Në këto vite buxhetet vendore janë dyfishuar. Pra, në raport me 2014-n sasia totale e fondeve që bashkitë kanë në dispozicion është dy herë më e madhe, borxhet e prapambetura janë ulur me 60%, investimet janë rritur pothuajse me tre herë, pesha e pagave brenda buxheteve të bashkisë ka rënë nga 70% në 43%, të ardhurat e veta janë trefishuar, nga 11 miliardë lekë në 35 miliardë lekë në 2023-shin. Kjo është një dëshmi e qartë e faktit që e gjithë qeverisja vendore ka funksionuar në mënyrë më efektive.

Sasia dhe cilësia e shërbimeve është rritur, shpërndarja në territor e këtyre shërbimeve është rritur. Mundësia e bashkive për të filluar dhe menduar në terma europianë ka filluar me faktin që një pjesë e madhe e bashkive ia dalin të marrin projekte në kuadër të Bashkimit Europian. Vitin e fundit totali i fondeve të tërhequra nga projektet e Bashkimit Europian nga bashkitë e vendit u afrohet 50 milionë eurove, që është një financim i qenësishëm dhe tregues që disa bashki ia dalin në atë rrugë, po jo të gjitha ia kanë dalë. Ndaj dhe bashkitë ende kanë një sërë sfidash jo të vogla, që ne duhet t'i trajtojmë me radhë.

Së pari, ka të bëjë me demografinë dhe lëvizjen e popullsisë. Kjo do të thotë se tipologjia e shërbimeve, mënyra se si aksesohen këto shërbime, tipologjia e ekonomisë që zhvillohet në një territor të caktuar, është e ndërruar tashmë nga demografia që ajo zonë ka dhe ky është një element që duhet marrë në konsideratë.

Të dhënat e censusit të 2023-it janë të rëndësishme dhe ne duhet t'i përdorim për të vlerësuar lëvizjen demografike në territor dhe mënyrën më të mirë për t'u ofruar shërbime qytetarëve tanë.

Bashkitë duhet të jenë gjithmonë e më shumë jo thjesht struktura përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve, për pastrimin apo riparimin e ndriçimit apo punë të përditshme komunale, të cilat pa dyshim që duhet t'i bëjnë se është detyra kryesore e bashkive, por bashkitë duhet të fillojnë gjithmonë e më shumë të luajnë një rol të rëndësishëm si faktor i zhvillimit ekonomik të territorit të tyre, të jenë aktorë që mendojnë në terma: si zhvillohet ekonomia, si vijnë më shumë investitorë në zonë, si krijohen më shumë biznese, si krijohet më shumë punësim dhe të kenë, gjithashtu, një rol aktiv duke marrë pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik të territorit të tyre.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që ne të sigurohemi që qytetarët shqiptarë të kenë akses në shërbime. Mënyra se si bashkitë i ofrojnë shërbimet dhe mundësia që u japin

qytetarëve për t'i aksesuar këto shërbime është një çështje që unë besoj se komisioni duhet ta vlerësojë në tërësi dhe ne duhet të sigurojmë që të gjejmë mekanizma apo modele që këto shërbime të jenë më të shpejta dhe më të afërta.

Gjithashtu, ka ardhur koha që ne të shohim edhe për një arkitekturë të re të qeverisjes vendore, që u përgjigjet në mënyrë të qartë sfidave që kemi përpara, jo thjesht gjeografike, por më shumë funksionale. Duhet të synojmë të kemi bashki financiarisht të qëndrueshme dhe të sigurohemi që i kanë mjetet e nevojshme, qofshin këto nëpërmjet mënyrës se si financohen nga taksat dhe tarifat vendore, qoftë edhe nga mënyra se si qeveria i financon nëpërmjet grantit, për t'i kthyer ato në më të qëndrueshme dhe më të parashikueshme.

Është shumë e rëndësishme që ne të shohim se si pushteti vendor do të ndërveprojë në mënyrë më të qenësishme me shërbimet e reja digjitale. Teksa është bërë një hap goxha i madh në ofrimin e shërbimeve digjitale në nivel qendror, nuk është ndjekur e njëjta shpejtësi në nivelin vendor, ndaj bashkitë duhet dhe mund të kenë një përshpejtim të mënyrës se si ofron shërbimet digjitale dhe transparente.

Gjithashtu, ne na duhet të kemi struktura vendore të afta që t'u përgjigjen sfidave që sjell për vendin procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Së fundi dua të them sërish që ne do të mbetemi gjithmonë shumë të hapur për të bashkëpunuar me opozitën, siç u tregua kjo në mënyrë të qenësishme me faktin që të gjitha kërkesat që opozita pati në procesin e krijimit të komisionit janë adresuar nga ana e mazhorancës dhe synojmë që kjo frymë të vijojë në vijimësi. Më vjen keq që sot anëtarët e Partisë Demokratike nuk erdhën në këtë takim! Shpresojmë që kjo të mos jetë një problem dhe të kthehet në një mekanizëm që në vijimësi të kemi bashkëpunim dhe ndërveprim. Synimi i këtij komisioni duhet të jetë jo si të zgjidhim një problem politik, por si të zgjidhim një problem administrativ-institucional, për t'u ofruar shërbime të qenësishme qytetarëve në të gjithë vendin, në çdo zonë, dhe të krijojmë një mekanizëm që t'u ofrojë qytetarëve shërbime jo thjesht në vitin e ardhshëm, në 2 vitet e ardhshme, por në 10-20 vitet e ardhshme në mënyrë efikase. Kështu që, unë besoj se këto janë thelbi i asaj që doja të thosha sot. Nëse dikush nga anëtarët ka diçka për të shtuar ose për të thënë, do ta vlerësoja shumë.

Vangjel Dule - Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Natyrisht, të gjitha sapo përmendët do të jenë objekt trajtimi në të gjitha mbledhjet e ardhshme të komisionit. Pavarësisht se koncepti im gjithmonë është se bota fillon atëherë kur ne fillojmë të merremi me të, shpresoj se do të marrim në konsideratë dhe është e vlefshme edhe puna që ka bërë një komision i ngjashëm gjatë legjislaturës së kaluar, pavarësisht se nuk pati rezultat konkludues. Pati dy monologë, një nga ana e mazhorancës, një nga ana e opozitës,

dy raporte që kanë përgatitur specialistët, por sigurisht që kohët kanë ndryshuar, kanë evoluar, ndaj besoj se do të ishte me vlerë që, krahas materialeve të tjera, stafi të na përgatiste edhe një dosje me materialet më të domosdoshme të punimeve të atij komisioni gjatë legjislaturës së kaluar.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku - Shumë faleminderit për sugjerimin!

Pa dyshim që do të marrim në konsideratë jo vetëm punën e komisionit në vitin 2017, të dy raportet, por edhe punën e bërë në mënyrë të ndërmjetme. Ka pasur një sërë diskutimesh me grupe të ndryshme ekspertësh në atë kohë. Unë kam qenë shpesh i ftuar në atë komision për të dhënë opinione dhe besoj që pa dyshim në këtë pikë ne do të duhet të marrim parasysh çdo kontribut të mundshëm, përfshirë dhe të dy raportet, por dhe punën e ndërmjetme të komisionit të 2017-s. Unë besoj se është shumë e vlefshme që ne të shqyrtojmë ose t'i rikthehemi një pjese të qenësishme të dokumenteve të 2014-s dhe rrugëtimit që reforma e 2014-s pati bërë. Madje, unë mendoj se bën sens që ne të shohim nga ana dokumentare edhe reformat e mëparshme. Unë besoj se një ndër punët që ne duhet të bëjmë, siç e thashë më parë, por kjo do të jetë temë diskutimi e mbledhjes së radhës, kur të fillojmë të bëjmë një plan pune, është që t'i kërkojmë Universitetit të Tiranës, duke e marrë si një ndër partnerët e rëndësishëm të ecjes përpara në këtë reformë, për të bërë një analizë fakt-historike të mënyrës se si ka funksionuar pushteti vendor në Shqipëri që nga viti 1912 dhe të gjitha fazat historike të kaluara: mënyrat se si është bërë ndarja, kompetencat, funksionimi, në mënyrë që komisioni të ketë mundësi që të shohë edhe një lëvizje historike të pushtetit vendor në Shqipëri, për të kuptuar jo vetëm si ka ardhur deri në situatën ku jemi sot, por duke e parë këtë në raport me aty ku duhet të shkojmë, që është Bashkimi Europian. Paralelisht me këtë unë besoj që ne duhet të shohim pak si funksionon kjo çështje edhe disa vende që kanë kaluar një proces të ngjashëm me ne, si Kroacia, Sllovenia, që janë edhe në madhësi të ngjashme me Shqipërinë, dhe ndërveprimin që ato kanë pasur me Bashkimin Europian. Kështu që, pa dyshim kjo është një çështje që duhet ta bëjmë dhe do ta bëjmë patjetër.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

U uroj suksese kolegëve!

E konsideroj një komision shumë të rëndësishëm, që përgatit strukturat vendore për procesin e integritit. Unë do t'ju kërkoja që ndër materialet që ne duhet të administrojmë dhe të studiojmë me shumë vëmendje të ishte një analizë për efektet pozitive dhe negative që ka sjellë reforma e vitit 2014.

Unë jam plotësisht dakord me ju kur thoni që objektivi duhet të jetë rritja e eficiencës së strukturave vendore, por, fatkeqësisht, kemi parë që numri i popullsisë ka rënë, numri i stafeve dhe administratës është rritur, ndërkohë që shumë nga shërbimet që ishin projektuar të administroheshin në nivelin vendor tashmë po centralizohen (e kam fjalën për trajtimin e mbetjeve, për ujësjellës-kanalizimet dhe shumë shërbime të tjera), kurse elementi i aksesueshmërisë së shërbimeve nga qytetarët në kuptimin gjeografik është rritur pak.

Kështu që, janë disa elemente ku duhet të jemi shumë të kujdesshëm, me qëllim që çdo kontribut që ne do të japim për sa i takon të ardhmes, veçanërisht për ato elemente që janë detyrim europian, dhe këtë ndoshta duhet ta trajtojmë si një kapitull më vete, se cilët janë ato elemente që ne duhet t'i përputhim me modelin europian...

Pra, duke qenë i një rëndësie të tillë, gjykoj që kjo analizë është e domosdoshme dhe pa dyshim blloku europian duhet të trajtohet në bashkëpunim, duke parë modelet e suksesshme që kanë vende të caktuara europiane.

Faleminderit edhe suksese komisionit!

Arbjan Mazniku - Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Jam shumë dakord me të gjitha komentet që ju bëtë. Unë dua që në mbledhjen e radhës, për të cilën do ta diskutojmë bashkë me zotin Boçi si bashkëkryetar për momentin më të përshatshëm, të prezantojmë bashkë me grupet e punës një agjendë dhe një strukturim të punës: fushat që duhet të ndjekim, sekretariatit teknik, grupin e ekspertëve që na parashikon tashmë vendimi i krijimit për t'i pasur, mënyrën se si do t'i ngremë, njerëzit që do të ftojme të bëhen pjesë e këtij grupi, që të kemi mundësi t'i diskutojmë bashkërisht dhe t'i vendosim bashkërisht.

Pika që ju ngrini është shumë e rëndësishme. Është një informacion që unë, kur e kam dëgjuar para 2 vjetësh për herë të parë, në momentin e parë nuk e besova dhe m'u desh t'i rikthehem për ta verifikuar, por 70% e *acquis communautaire*, e ligjeve të Bashkimit Europian, zbatohet në nivel vendor. Do të thotë që 70% e korpusit të ligjeve të BE-së ndikon në një mënyrë apo një tjetër në pushtetin vendor. Teksa integrimi është proces i shtetit shqiptar me Bashkimin Europian, një pjesë e këtij integrimi impakton në mënyrë të drejtpërdrejtë në pushtetin vendor dhe ju keni shumë të drejtë që duhet ta trajtojmë. Do ta trajtojmë çështjen e integritit dhe anëtarësimit si një kapitull të posaçëm me një fokus të posaçëm në mënyrën se si duhet të adaptohen bashkitë dhe pushteti vendor në tërësi në raport me këtë çështje.

Zonja Kuko.

Romina Kuko – Faleminderit, kryetar!

Së pari, do të duhet të bëjmë një koordinim shumë të mirë me qeverinë lidhur me iniciativat ligjore apo nisma, të cilat prekin pushtetin vendor, sidomos në ligje të caktuara sektoriale. Kështu që, ndoshta në këshillin konsultativ do të duhet të kemi një ndërveprim më të mirë me bashkëkryetarët e këshillit konsultativ dhe nëpërmjet ministrit për Shtetin për Parlamentin, duhet të marrim informacion në kohë reale, në mënyrë që mos të marrim angazhime ligjore, të cilat do të duhet t'i zhbëjmë pas përfundimit të reformës.

Për sa i përket pjesës së integritit europian, pushteti vendor përfshihet në kapitullin 22, i cili ka të bëjë edhe me fondet strukturore. Kështu që, aty ka disa ekipe këshillimore, të cilat këshillojnë qeverinë për kapitullin 22. Do të sugjeroja që të gjejmë një mënyrë për t'i pasur edhe ata pranë këtij komisioni të reformës, në mënyrë që të jemi në unison sa u përket kërkesave dhe përputhjes me *acquis communautaire*.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zonja Kuko!

Pa dyshim që do të punojmë ngushtësisht së pari me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, si linjézimi kryesor i ndërveprimit tonë me qeverinë, dhe nëpërmjet ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor me të gjithë qeverinë. Do të sigurohem që sipas sektorëve specifikë të kemi njerëz nga secila strukturë qeverisëse sipas fushës respektive që mbulon pushtetin vendor, në mënyrë që të sigurohem që të kemi këtë ndërveprim.

Pa dyshim që Këshillin Konsultativ, si institucion tashmë me njëfarë pjekurie për ndërveprim midis qeverisë qendrore dhe vendore, do ta përdorim edhe ne si një platformë të qenësishme të ndërveprimit dhe të kuptimit më shumë për nevojat e pushtetit vendor.

Unë besoj se veç kësaj (kjo do të vlente për mbledhjen e radhës) në dy ose tri faza të diskutimit publik do të ishte e udhës që anëtarë të komisionit, jo domosdoshmërisht i gjithë komisioni, anëtarë dyshe dhe treshe të komisionit, të kenë mundësi vetë të lëvizin dhe të bëjnë dëgjesa drejtpërdrejt në zona të ndryshme të territorit me grupe të ndryshme, në mënyrë që ta prekim deri diku drejtpërdrejt si anëtarë komisioni problematikat që qytetarët në territor kanë në raport me pushtetin vendor, dhe më pas t'i transpozojmë ato në mënyrë të qenësishme.

Kështu që, unë do të kisha shumë dëshirë që ky komision të jetë më shumë një grup pune sesa një komision, një vend ku të ketë një punë të prekshme, të mirëfilltë, diskutime të qenësishme, të hapura dhe të shohim të gjitha opsionet e mundshme dhe të synojmë për t'u dhënë zgjidhjen më të mirë.

Vasil Llajo – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Përsëritës të gjithë kolegët dhe uroj mbarësinë e këtij komisioni, si i konstituuar për herë të parë sot, i cili do të na hapë rrugën për konstituimin e reformës territoriale! Mbështes

fort fjalët që thatë ju, që ne duhet të adaptohemi, se dhe Darvini dikur ka thënë se lloji që nuk adaptohet është i destinuar të shuhet.

Pra, duke adaptuar përherë reformat, jemi gjithmonë të përditësuar, jemi në një gjendje të gjallë, aktive dhe dinamike për t'u përshtatur në të gjitha situatat.

Në këtë moment ka ardhur koha që të adaptojmë edhe ne reformën territoriale dhe, mbi të gjitha, reformën territoriale mbi objektivin dhe detyrimin që kemi ndaj qytetarëve, për t'u afruar me Bashkimin Europian dhe për të plotësuar detyrimet tona, sepse, siç përmendët dhe ju, ndoshta viti 2030 do të na gjejë si një pjesë ose një shtet të barabartë midis këtij grupimi madhor të komunitetit europian.

Do të bazohemi gjithmonë mbi konventat e komunitetit europian, që të jemi sa më afër tyre. Shpresoj dhe jam i bindur që konventat për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve do të merren parasysh në këtë reformë territoriale.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti Llajo!

Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër, unë besoj që për sot mund ta konsiderojmë mbledhjen e mbyllur dhe komisionin të konstituuar. Do t'ju lajmërojmë për mbledhjen e radhës në momentin që është i përshtatshëm, duke e ditur që shumë nga ju, veçanërisht tani që jemi në muajin e buxhetit, kanë goxha ngarkesë.

Besoj se në mbledhjen e radhës mund të diskutojmë planin paraprak të punës ts komisionit dhe ngritjen e strukturave ndihmëse, qoftë grupin e ekspertëve, qoftë sekretariatit teknik.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA